

BURGJET E SHOQIPËRISË DHE DHUNIMI I LIRIVE THEMELORE

RAPORT MONITORIMI

Tetor-Dhjetor 2022

QENDRESA
QYTETARE



NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al



AUTOR
**KRISELDA
DEDNDREAJ**

Tabela e përmbajtjes:

Hyrje

Individi i kufizuar dhe pasojat psikologjike

Te drejtat, liritë, dhe rujtja e integritetit të të burgosurit

Spitalet e burgjeve, gjendja mendore e të burgosurve, e prania e stafit mjekësor

Burgu i Zaharise dhe shkelja e të drejtave themelore të njeriut.

Sistemi i burgjeve për të mitur

Rekomandime

Bibliografia

Hyrje

Sistemi i drejtësisë kriminale përfaqëson një ndër shtyllat kryesore të shtetit të së drejtës me një ndikim të lartë në shoqëri. Në kete shtyllë ashtu si në të gjitha aspektet e jetës private ashtu edhe publike htefi ka për detyrë mbrojtjen dhe sigurinë e shoqërisë si dhe garantimin e ruajtjes së dinjitetit dhe integritetit njerëzor të individëve autorë të krimeve.

Nëse policia dhe gjykata kanë role parandaluese dhe aplikuese duke përdorur ligjin, burgjet janë institucionet kryesore kontribuese në përmirësimin e sjelljeve kriminale dhe aftësimin e riintegritit të të burgosurve në shoqëri, pasi ata kryejnë dënimin. Kontrolli, mbikqyrja, siguria, dhe rehabilitimi janë pikat kryesore të cilat institucionet penitenciare duhet t'i vendosin në mënyrën se si ato veprojnë.

Në një raport të publikuar nga Këshilli i Europës, ku janë përpiluar statistikat për 49 vende të bashkimit European, Shqipëria mban numrin më të lartë të të burgosurve për 100 mijë banorë në rajon, ndër numrat më të lartë të të burgosurve nën moshën 35 vjecare, si dhe ndër numrat më të lartë të vetëvrasjeve të kryera brenda institucioneve të vuajtjes së dënimit.

Këto shifra shfaqen të larta e vene pikëpyetje të shumta mbi mënyrën se si gjërat funksionojnë brenda sistemit penitenciar.

“Arsyeja pse krimi ekziston nuk vjen prej gjenetikës së personit, apo vetëm prej zgjedhjeve individuale të tij, por vjen si kombinim i kushteve natyrore dhe ambientit shoqëror në të cilin individi vendoset.”- Enrico Ferri

Individi i kufizuar dhe pasojat psikologjike

Efektet sociale ndodhin në dy faza të jetës së të burgosurit: periudhën e izolimit dhe rihyrjen në shoqëri. Të gjithë të burgosurit përjetojnë ndryshime psikologjike në kohën e burgimit. Ata gjithashtu përjetojnë një status të reduktuar social pas kthimit të tyre në komunitet. Rezultati është shpesh një jetë e vetmuar dhe e pafuqishme për ish të burgosurin. Efektet kryesore psikologjike të burgosjes janë vetëdënim, faji dhe mërzia, duke rezultuar në humbje të perspektivës dhe të vetëbesimit. Pas lirimit, të burgosurit shpesh tërhiqen nga të tjerët. Ata

gjithashtu ndihen armiqësorë ndaj shoqërisë dhe sistemit të drejtësisë penale dhe vazhdimisht në ankth. Burgimi gjithashtu shumëfishon problemet e tyre financiare paraekzistuese. Të burgosurit shpesh marrin trajnim profesional gjatë izolimit, por rrallë punësohen në të njëjtën fushë pune pas lirimit të tyre. Si rezultat, ish të burgosurit janë shumë të cënueshëm ndaj përfshirjes kriminale në të ardhmen.

Kohëzgjatja e dënimit, trajtimi nga ana e stafit të institucionit të vuajtjes së dënimit, janë shkaktare kryesorë të pasojave psikologjike të mbetura tek të burgosurit. Ankthi, stresi, paniku, depresioni, depersonalizimi, paranoia, rënia e vetëvlersimit, janë vetëm disa nga efektet psikike që burgu shakton tek të burgosurit. Pasoja të tilla të gjendjes mendore, megjithëse të vështira, mund të jetë të rikuperueshme në rastet e dhënies së ndihmës ndaj të dënuarve si gjatë periudhës së vuajtjes së dënimit, ashtu edhe pas daljes nga burgu. Puna e sistemit penitenciar nuk mbyllet në momentin që mbaron dënimi për të burgosurin, por duhet vëmendje dhe përpjekje për riintegrimin në shoqëri dhe për rregullimin e gjendjes psikologjike të këtyre individëve.

Raportime të shumta si nga media edhe nga organizata joqeveritare, kanë ngritur alarmin mbi kushtet te të cilat të burgosurit jetojnë, trajtimin nga stafi, mungesa e psikologëve, e se si jetesa në burgjet shqiptare ndikon në rëndimin e gjendjes mendore të të burgosurve.

Te drejtat, liritë, dhe rujtja e integritetit të të burgosurit

Garantimi i të drejtave, përmbushja e detyrimeve ndaj të dënuarve, e sigurimi i rehabilitimit janë pika kyçe në mënyrën se si sistemi penitenciar duhet të funksionojë. Vendosija e individëve në burg kryhet me qëllimin e ndëshkimit dhe rehabilitimit në mënyrë paralele, duke i siguruar të dënuarve ruajtjen e integritetit dhe dinjitetit njerëzor. Kjo gjë arrihet duke krijuar kushte të denja të cilat e kryejnë qëllimin e privimit të lirise, por nuk çenojnë cilësinë e jetesës dhe esencën e të drejtave themelore të të burgosurit. Në të njëjtën kohë duhen burime njerëzore të trajnuara mirë si stafi, gardianët, mjekët, psikologët të cilet janë të ngarkuar me kryerjen e detyrave kryesore ndaj individëve të cilëve u privohet liria.

Kushtet fizike të ambienteve të kryerjes së dënimit kanë një tjetër problem madhor. Raportime të shumta kanë bërë thirrje instancave për rregulimin dhe rikonstruktimin e burgjeve të Shqipërisë. Avokati i Popullit, Komiteti Shqiptar i Helsinkit si dhe organizata të tjera, që nga viti 2017 ngrenë shpesh here shqetësimin në lidhje me situatën momentale përsa i perket rrethanave në të cilat të burgosurit e Shqipërisë jetojnë. Duke filluar që nga kushte jo të denja për të burgosurit, lagështire, mungesë dhomash, mbipopullim, e deri tek pasojat psikologjike. Kushte jo të mira të cilat çënojnë integritetin e të burgosurit ndodhen në të gjitha hallkat e burgjeve, nga paraburgimi e deri në burgjet e sigurisë së lartë, ndër to identifikohet dhe sistemi 41BIS.

41BIS

Sistemi 41 BIS, prezantuar për herë të parë në vitet 90 në Itali, i aplikuar atje për shumë vite, e tashme prej 3 vitesh edhe në Shqipëri, 41 BIS konsiston në ndërtimin e burgjeve të posaçme me qeli shumë më të vogla, monitorim 24 orë nga kamera e policë, mos lejim të asnjë mjeti personal nga të burgosurit brenda në qeli, takime e telefonata vetëm një herë në muaj e edhe këto të monitoruara plotësisht nga ana e policisë.

Ky regjim vjen me pikëpyetje si nga aspekti i sigurimit të ruajtjes së dinjitetit njerëzor të të burgosurve e gjithashtu edhe nga efektiviteti që regjimi sjell.

Përveç ambientit të jetesës në sipërfaqe shumë të vogël, të burgosurit privohen nga kohë ajrimi e përshtatshme, e nga privim i çdo forme komunikimi të lirë me të afërm. Në të njëjtën kohë që këto mund të shihen si metoda të parandalimit të zhvillimit të aktiviteti kriminal, duket se një sistem i tillë, sipas Konventës Europiane të së Drejtave të njeriut, shkakton trajtim çnjerëzor për të burgosurit nën këtë regjim.

"...do të ishte e papajtueshme me dinjitetin njerëzor – që qëndronte në thelbin e sistemit të Konventës – t'u privohej liria personave pa u përpjekur për rehabilitimin e tyre."- është shprehur Gjykata Europiane e të Drejtave të njeriut.

Spitalet e burgjeve, gjendja mendore e të burgosurve, e prania e stafit mjekësor

Dhuna e abuzimi duket se janë kryefjalë në portretizimin e burgjeve në Shqipëri. Përveç kushteve jo optimale në burgje, shihet se edhe në institucionet më të posaçme si spitali i burgut, kushtet janë akoma edhe më të tmerrshme.

Në spitalin e burgut shihet gjendje e rënduar në të cilën këta të burgosur me sëmundje mendore vuajnë dënimin ndodhen. Gjendja e rënduar psikike e shumë prej dënuarve do të kërkonte në fakt trajtimin e menjëhershëm të personave në psikiatri, e të mos ishim përballë vuajtjes së dënimt në sistemin penitenciar, e duket se vetë dhënia e masës së dënimt me burg dhuron të drejtat e njeriut.

E përpos padrejtësive në thelb të këtyre të dënuarve, shohim se edhe brenda qelive, ka ndasi mes të burgosurve. Disa prej tyre e pajisur me televizor e frigorifer në qeli, e shumë prej tyre me mure të mykur nga lagështia, e veç një krevat e një tavolinë në qeli. Në spitalin e burgut shihet të ketë mugesat të mëdha të stafit mjekësor, e në këtë spital ku të shtruar janë dhjetëra të dënuar me sëmundje të ndryshme mendore, ka vetëm një psikiatër. Mungesa e stafit të domosdoshëm shihet të ketë edhe në institucionet e vuajtjes së dënimt të të miturve, ku vazhdimisht gjatë viteve shfaqet mungesa e punonjësve social e psikologëve. Sipas Kodit Penal për të Mitur, e Konvetave nderkombetare të cilat trajtojnë posacerisht ndjekjen penale të të miturve, prania e minimumi një psikolog në ambientet e burgut për të mitur është e domosdoshme.

Përveç spitalit të burgjeve, shihet se si edhe brenda burgjeve bashkëjetojnë të dënuar me gjendje të rëndë mendore, me ata me gjendje të kontrolluar. Ky problem është ngritur nga Komitetit Shqiptar i Helsinkit si dhe nga Avokati i Popullit.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka pasur në fokus disa raste të veçanta përgjatë viteve të fundit, të abuzimeve të shumta e dhunës brenda këtyre burgjeve. Raportohen raste të vetëvrasjeve brenda burgut si pasoje e keqtrajtimin në ambientet e vuajtjes së dënimt dhe çështje të tjera të cilat rrisin shqetësimet për dhunim të të drejtave themelore.

Burgu i Zaharise dhe shkelja e të drejtave themelore të njeriut.

Burgu i Zaharise i quajtur burgu "ferr" për vite me rradhe ka vazhduar aktivitetin ku mbi 80 të dënuar me gjendje të rënduar mendore, jetonin me të burgosurit e tjere me mase mjeksore të detyruar, por me gjendje mendore të rregullt.

Gjendja në të cilën ambientet e burgut të Zaharise ndodheshin ishin të pamundura për të siguruar jetesën e të burgosurve. Duke munguar rikonstruktimi prej dekadash, burgu kishte arritur një situatë ku mund të rrezikonte dhe gjendjen shëndetsore të të dënuarve.

Duke iu bashkëngjitur kushteve jo të denja, ky burg në kapacitetin e 190 personave, për vite me rradhe ka mbajtur mbi 350 të burgosur. Shumë organizata të të drejtave të njeriut duke përfshirë edhe Komitetin Shqiptar të Helsinkit kerkuan mbylljen e këtij institucioni, kërkesë e cila arriti të realizohej një vit më parë.

Burgu i Zaharise u mbyll duke bërë që të gjithë të dënuarit të dergoheshin në burgun e Shën Kollit. Kjo u pa si një zgjidhje pozitive për këta të dënuar, por duket se keqtrajtimi për ta nuk do të kishte të mbaruar. Kushtet në Shën Koll janë të një gjendje të mjerueshme e rënduar sidomos nga mbipopullimi i këtij burgu.

Problematike tjetër e një shkalle të lartë është se si në shohim të bashkejetojnë të dënuar me masën e mjekimit të menjëhershme, të dënuar me gjendje të rënde psikike me semundje të ndryshme mendore, e gjithashtu të dënuar të shëndetshëm.

Për të dënuarit me masën e mjekimit të menjëhershëm, ata me gjendje të rënduar psikike, e ata me semundje të karakterit të transmetueshëm ose të rëndë, duhet të ketë ambiente të posacme, mjekë dhe aparatet e nevojshme për sigurimin e trajtimit të duhur të këtyre të burgosurve. Gjendja është alarmante si nga aspekti i burimeve njerezore në mjekë, mjekë psikiatër e tjetër staf mjekësor, e deri tek mjetet e nevojshme për kurimin dhe mbajtjen në kontroll të këtyre semundjeve të karaktereve të ndryshme.

Në bazë të Ligjit për të Drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve me Burgim, ndërtimi i fasiliteve të nevojshme, rritja numrit e stafit mjekësor, sigurimi i medikamenteve dhe cdo mjeti të nevojshme për sigurimin e

mbajtjes nën kontroll dhe mos precipitimit të semundjeve, do të ishin disa nga elementet bazë për të ruajtur shëndetin dhe dinjitetin e të burgosurve ndërkohë që kryhet periudha e vuajtjes së dënimit.

Sistemi i burgjeve për të mitur

Shqipëria ka vetëm një burg për të mitur i cili ndodhet në Kavajë, e në të njëjtën kohë asnjë institucion riedukimi duke bërë kështu që përballja e parë e të miturit me çfaredo lloji të shkeljeve apo veprimi me karakter kriminal, është burgu. Kjo rrezikon thellimin e të rinjve në botën e krimit.

Statistika nga Drejtoria e Burgjeve tregojnë se përqindja me e lartë e veprave të kryera nga këta të mitur është vjedhja, duke ngritur edhe shumë pikëpyetje mbi shkaqet shoqërore e ekonomike që i shtyjnë këta të mitur për të kryer vepra të tilla.

Mungesa e një institucioni riedukimi duket problematik pasi këta të mitur njohin sistemin e ndeshkimit, pa arritur të njohim regjime të cilat do të ndihmonin në rehabilitimin, edukimi e sigurimin e integritetit në shoqëri pa rekorde kriminale.

Raste të shumta janë venë në vëmendje si nga media ashtu edhe nga organizata joqeveritare e shoqëri civile, ku vihet re trendi se të miturit e dënuar janë shumica e probleme të shumta ekonomike në familjet e tyre. Keto janë kembana alarmi në aspekt shoqëror të cilat vertetojnë cikle shumë të gjata të sjelljeve të rrezikshme shoqërore, që në moshe shumë të vogël.

Një tjetër problematikë që haset është mungesa e theksuar e psikologeve e mesuesve në burgun për të mitur. Shteti duhet të sigurojë që të miturit të rehabilitohen në ambientet e burgut, të kenë asistencë të plotë të punonjësve social, të kenë aksesin për psikolog e në të njëjtën kohë të vazhdojnë procese mesimore në menyrë që pasi të lenë qelinë, të kenë mundësinë e integritetit të menjëhershëm në shoqëri. Megjithatë në burgun e Kavajës vihet re mungesa e stafeve të domosdoshme për mbarevajtjen e kohës së vuajtjes së dënimit, duke bërë që periudha brenda burgut të rrezikojë një mungesë totale të rehabilitimit e riintegritetit pas përfundimit të dënimit.

Vjedhja është vepra penale me e shpëstë e kryer nga të miturit duke zenë 40% të të dënuarve, e moshë prevaluese është 16-18 vjec. Vihet re se në 4 vjeçarit e fundit sipas raporteve të monitorimit të Policisë së Shtetit, një numër i lartë janë edhe persëritës. Duke qenë veprat kryesore penale janë ato me karakter ekonomik, shihet edhe një reflektim i po kësaj gjendje ekonomike ku këta të rinj ndodhen.

Rëndësi të veçantë duhet kushtuar edhe gjendjes mendore në të cilën e rinjtë vendosen në momentin e dhënies së dënimit me burgim, periudhën e vuajtjes së dënimit, e më pas edhe aftësia dhe ndihma që i jepet të miturve për t'u integruar në shoqëri. Qellimi kryesor që sistemi i burgut për të mitur duhet të ketë është ruajtja e një gjendje të qëndrueshme mendore, përmirësim i aftësie të të miturit, trajtim i denjë dhe rehabilitim, e së fundmi riintegrim i suksesshem në komunitet pas perfundimit të dënimit.

Rekomandime

1. Duhet të ketë vëmendje e një rëndësie të veçantë fakti që burgu nuk është vetëm institucion ndëshkimi por edhe rehabilitimi në këtë mënyrë duhet të ekzistojnë aktivitete të cilat risin njohuri, edukim e gjithashtu edhe aktivitete të karakterit artistik, të cilat i mundesojnë të burgosurve marrjen e njohurive si dhe aftësim të fusha të ndryshme.
2. Aplikimi i një forme tjetër të sistemit të burgjeve i cili është regjimi 18-21 vjec. Kjo grupmoshe është specifikisht e prekur nga krimi e në të njëjtën kohë e rrezikuar për pasojat psikike që vendosja në bashkejetesë me grupmosha e kategori të ndryshme të veprave penale, mund t'i shkaktojë. Në Shqipëri 18 deri në 21 vjeçarët zënë një numër relativisht të madh në burgje e vihet re se shumë prej tyre kanë tendencë të jenë edhe perseritës.
3. Marrëdhënia e shtetit me të burgosurin nuk duhet të perfundojë kur mbaron koha e vuajtjes së dënimit, por të zgjase për një periudhë kohe pas daljes nga qelia, për të siguruar rehabilitimin në shoqëri dhe mundësinë e vazhdimin të një jetese me dinjitet edhe pas daljes nëpërmjet politikave të punësimit.
4. Duhet të sigurohet mbrojtja e dinjitetit dhe shëndetit të të burgosurve nëpërmjet masave që sigurojnë medikamente, facilitete dhe stafin e nevojshëm për trajtimin e shqetësimeve shëndetësore të të burgosurve, si ato fizike dhe psikologjike.
5. Ndertimi i një institucioni riedukimi për të miturit, për të funksionuar si një institucion ku i mituri merr trajtim të veçantë për korrektimin e sjelljes, duke shmangur kështu pasojat psikologjike të të qenit në një burg.

Bibliografia

- National University article on sociological theories of crime
- Aksesuar në: <https://www.nu.edu/blog/sociological-theories-of-crime/>
- Efektet Psikologjike të burgut artikull Aksesuar në: <https://sq.warbletoncouncil.org/efectos-psicologicos-encarcelamiento-mente-reclusos-2727>
- Efektet psikologjike qe shkakton burgu Aksesuar në: <https://www.linkedin.com/pulse/10-psychological-effects-prison-what-happens-your-gednwy-md-dr-g->
- Gjykata e Strasburgut Sanksion Aksesuar në: <https://ahc.org.al/njoffim-per-shtyp-14/>
- Komiteti Shqiptar i Helsinkit Aksesuar në: <https://ahc.org.al/te-parandalohen-vetevrasjet-ne-sistemin-e-burgjeve-3/>
- Inside Story "Burgu i të Miturve" Aksesuar në: <https://top-channel.tv/2019/02/06/top-story-burgu-i-te-miturve-ne-kavaje-pa-asnje-psikolog/>
- Punim shkencor UNITIR Aksesuar në: <https://unitir.edu.al/roli-i-psikologut-ne-parandalimin-dhe-trajtimin-e-problemeve-te-shendetit-mendor-ne-sistemin-e-burgjeve-gjate-dekades-se-fundit/>
- Plan per permiresimin e sistemit penitenciar ne Shqiperi Aksesuar në: <https://rm.coe.int/actionplan-prison-system/native/1680968ab1>
- Komiteti Shqiptari Helsinkit mbi ceshtjen e burgut të Zaharisë Aksesuar në: <https://ahc.org.al/trajtim-cnjerezor-ne-burgun-e-zaharise-kruje-i-te-semureve-mendore-me-mjekim-te-detyruar/>
- Ligji për të Drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve me burgim Aksesuar në: [https://www.drejtësia.gov.al › uploads › 2019/02](https://www.drejtësia.gov.al/uploads/2019/02)

#QËNDRESË / MIRËQEVERISJE

QENDRESA
QYTETARE



NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al